REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:074278
Datë: 08.07.2022
Numri i dokumentit: 03214950

C.nr.234/2020

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË – Departamenti i përgjithshme, Divizioni civil, me gjyqtar Robert Tunaj , në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit K.E.D.S.Sh.a.me seli në Prishtinë , kundër të paditurit I. G., me nr. personal ..... , me vendbanim në Suharekë, për kompenzim dëmi, jashtë seance, më datë 08.07.2022, mori:

A K T G J Y K I M
-Për shkak të padëgjueshmërisë/ mosbindjes -

l.APROVOHET kërkesëpadia e Paditësit KEDS në Prishtinë, si e bazuar.

II. DETYROHET i padituri I. M. G. që paditësit KEDS ne Prishtinë, ti kompensoi shumën prej 213,24 € në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar, me kamat ligjore prej 8 % , duke llogaritur nga data e marrjes se këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive .

III. Detyrohet i padituri e në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, për taksa gjyqësore ti paguaj shumen prej 20€ në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi KEDS distrikti në Prishtinë pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë me datën 24.06.2020, kundër të paditurit I. G. , me kërkesëpadi për kompensim te demit.

Në padinë e paraqitur, paditësja paraqet provat: Aktgjykimi P.nr.478/18 të dt.30.09.2019, Fatura nr.DPZ16HP..... i dt. 14.01.2016, kalkulimin e rikthimit te humbjeve.

Gjykata një kopje të padisë dhe provave të bashkangjitura padisë i ka dorëzuar palës së paditur me vërejtje për dhënien e përgjigjes në padi, duke e udhëzuar palën e paditur që të paraqet përgjigje me shkrim në padinë e palës paditëse. Ndërsa në anën tjetër edhe e ka njoftuar për pasojat e mosveprimit sipas asaj vërejtje.

Pasi që pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në padi si dhe duke pasur parasysh faktin se themelësia e kërkesë padisë del nga faktet e treguara në padi dhe të njëjtat nuk janë në

2020:074279

kundërshtim me provat e bashkangjitura në padi, gjykata në kuptim të nenit 150 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që të miraton kërkesëpadinë e palës paditëse.

Gjithashtu bazë për miratimin e kërkesëpadisë, gjykata e vlerësoi dëmin të cilin i është shkaktuar palës paditëse me kryerjen e veprës penale vjedhje e shërbimeve, si dhe faturës për rikthimin e humbjeve. Ashtu siç e përcaktohet edhe me nenin 169 par. 3 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ashtu që edhe miratoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se shuma prej 213,24€, është reale sipas llogaritjes së bërë e cila është në përputhje me nenin 31 par. 1 dhe 2 të Rregullave për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Gjykata vendosi që pala e paditur të paguajë kamatën vjetore prej 8 % nga data e marrjes së aktgjykimit , deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-së, duke miratuar shumën prej 20,€ për taksa gjyqësore për padinë e paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:074278, 08.07.2022

P r o c e s m b a j t e s i

_____

G j y q t a r i

_____
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

2020:074279